Vendim nr. 304, datë 28.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Asim Vokshi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 28.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (Xh) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **XHULIAN HOXHA,** i përfaqësuar nga avokati Qani Hasa, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 64, datë 11.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. (15) 87-2024-98, datë 08.04.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1516, datë 14.10.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, pika 1, 15, 18, 27, 29, 30, 31, 32, 34, 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 1, 6, 13, 14 dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ)* dhe Protokolli nr. 12 i saj; nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (*Prokuroria e Posaçme*) për kryerjen veprave penale "Vrasja me paramendim", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", në formën e veçantë të bashkëpunimit, "Grupi i strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 78, paragrafi 2, 278, paragrafi 4, në lidhje me nenet 28, 334 dhe 333/a të Kodit Penal (*KP*). Sipas organit të akuzës, nga hetimet ka rezultuar se kërkuesi dhe i bashkëpandehurit E.H. planifikuan dhe organizuan pajisjen me armë për të vrarë persona, me të cilët ishin në konflikte, si dhe vranë me armë zjarri, në datën 20.07.2020, shtetasin E.R. Roli i kërkuesit në këtë krim ishte mbajtja nën mbikëqyrje e viktimës E.R., duke njoftuar për çdo lëvizje ose vendndodhje të tij, drejtuesin e grupit të strukturuar kriminal, me qëllim që ky i fundit të koordinonte veprimet e anëtarëve të grupit kriminal deri në momentin që u ekzekutua. Po kështu, në datën 29.07.2020, rreth orës 22:00 të mbrëmjes, në Elbasan, në lagjen "Emin Matraxhiu", në vendin e quajtur "Belebej", është gjetur i pajetë viktima R.R. Edhe për këtë ngjarje roli i kërkuesit dhe i të bashkëpandehurit E.H. ishte mbajtja nën mbikëqyrje e viktimës R.R., duke njoftuar për çdo lëvizje ose vendndodhje të tij, me qëllim koordinimin veprimeve deri në momentin që këtë detyrë ia ngarkoi të bashkëpandehurit E.H., i cili edhe e ekzekutoi, duke e goditur disa herë me mizori pas shpine, derisa i shkaktoi vdekjen.

2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 64, datë 11.10.2023, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për veprat penale "Vrasja me paramendim" për interes, në formën e veçantë të bashkëpunimit, të grupit të strukturuar kriminal, në dëm të viktimës E.R.; "Vrasja me paramendim", për interes, në formën e veçantë të bashkëpunimit, të kryer me egërsi dhe mizori, në dëm të viktimës R.R.; "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", të kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal; "Grupi i strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 78, paragrafi 2, 28, pika 4, 278, paragrafi 4, 333/a, paragrafi i dytë, dhe 334, pika 2, të KP-së, si dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesi dhe Prokuroria e Posaçme.

3. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 15 (87-2024-98), datë 08.04.2024 (*vendimi nr. 15/2024*), ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për sa është disponuar në lidhje kërkuesin.

4. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2025-1516, datë 14.10.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se pretendimet e ngritura në interpretim të shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit. Ky kolegj i ka shqyrtuar edhe në themel këto pretendime, duke arritur në përfundimin se ato janë haptazi të pabazuara.

5. Në datën 20.05.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 01.06.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

6.1. *Të drejtën për proces të rregullt* në drejtim të:

6.1.1. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* pasi gjykatat nuk kanë marrë si provë dëshminë e shtetasit E.A., personi që ka porositur vrasjet, por ka pranuar provën indirekte, dëshminë e N.D., i cili ka deklaruar se faktet i ka mësuar nga E.A. Sipas kërkuesit, duke mos u pyetur shtetasi E.A., atij nuk i është dhënë mundësia të kundërshtojë provat e paraqitura nga organi i akuzës, si dhe të paraqesë prova në mbështetje të pretendimeve të tij.

6.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm se përse kanë aplikuar dënimin maksimal me burgim të përjetshëm. Ato nuk kanë analizuar rrethanat faktike të të dyja vrasjeve për të cilat është akuzuar kërkuesi, për sa i përket rolit të tij në këto vrasje, si dhe rrethanat personale dhe familjare të tij.

6.1.3. *Së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, të garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës, pasi deklarimet e bashkëjetueses A.Sh. të dhëna gjatë hetimeve paraprake nuk duheshin bërë pjesë e dosjes gjyqësore. Shtetasja A.Sh., bazuar në nenin 158 të KPP-së, gëzonte të drejtën për të mos dëshmuar dhe këto dëshmi nuk mund të përdoreshin si prova për dënimin e tij.

6.2. *Lirinë personale*, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së, pasi është duke vuajtur në mënyrë të padrejtë heqjen e lirisë përmes burgimit të përjetshëm.

6.3. *Parimin e prezumimit të pafajësisë,* pasi në rastin konkret nuk ekzistojnë prova direkte që provojnë kryerjen e veprave penale. Gjykatat kanë përmendur si prova dëshmitë e disa shtetasve, por pa arsyetuar se çfarë provojnë këto dëshmi. Ato e kanë dënuar vetëm mbi bazën e një prove të vetme që është dëshmia e bashkëpunëtorit të drejtësisë E.H. Në dëshminë e tij ky shtetas ka shtrembëruar të vërtetën, i ndihmuar edhe nga të dhënat që i ka mundësuar organi procedues.

6.4. *Parimin e propocionalitetit*, pasi vendimi i dënimit me burgim të përjetshëm për kërkuesin nuk justifikon interesin publik dhe gjendjen që e ka diktuar atë.

6.5. *Të drejtën për të mos iu nënshtruar trajtimit degradues*, të garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i KEDNJ-së, pasi dënimi me burgim të përjetshëm pa mundësi reale rishikimi mund të konsiderohet trajtim çnjerëzor.

6.6. *Të drejtën për jetë private dhe familjare,* të garantuar nga neni 8 i KEDNJ-së, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm përmes arsyetimit arbitrar të ligjit nuk kanë pranuar kërkimin e shtetases A.Sh. për të fituar nga e drejta për të mos dëshmuar.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

7. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të pranueshmërisë dhe jurisprudencën e Gjykatës, Kolegji vëren se kriteret *ratione personae* dhe *ratione temporis* janë të përmbushura.

9. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, sipas të cilit individi mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë *(shih vendimet nr. 61, datë 19.09.2024; nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese).*

10. Lidhur me këtë kriter, Kolegji vëren se pretendimet për cenimin *së drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimit degradues,* me pretendimin se dënimi me burgim të përjetshëm pa mundësi reale rishikimi mund të konsiderohet trajtim çnjerëzor dhe *së drejtës për jetë private* konstatohet se kërkuesi nuk i ka ngritur as në ankim dhe as në rekursin e tij drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, Kolegji çmon se për këto pretendime ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

11. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, kërkuesi i ka parashtruar ato më parë, në formë e në substancë, në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë Kolegji çmon se në lidhje me to e plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

12. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuesit parashtrohen në kuadër të *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës (në aspekt të *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, standardit të arsyetimit të vendimit*), *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, lirisë personale, parimit të prezumimit të pafajsisë*, si dhe të *parimit të propocionalitetit në caktimin e dënimit,* të garantuara nga nenet 32, 27, 30 dhe 17 të Kushtetutës.

13. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* duke argumentuar se gjykatat e faktit nuk kanë marrë si provë dëshminë e shtetasit E.A., personi i cili ka porositur vrasjet, por ka pranuar provën indirekte, dëshiminë e shtetasit N.D., i cili ka deklaruar se këto fakte i ka mësuar nga ai. Sipas kërkuesit, duke mos u pyetur shtetasi E.A. atij nuk i është dhënë mundësia të kundërshtojë provat e paraqitura nga organi i akuzës, si dhe të paraqesë prova në mbështetje të pretendimeve të tij.

14. Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë së armëve në procesin penal, si pjesë e procesit të rregullt ligjor, synon të realizojë një debat real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë

që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe në dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër dhe secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të prezantuar çështjen e vet, kushte të cilat nuk e vendosin në një pozitë më pak të favorshme përkundrejt kundërshtarit (*shih vendimet nr. 23, datë 23.07.2009; nr. 19, datë 18.09.2008; nr. 13, datë 21.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e provave në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit kushtetues, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, vërehet se kërkuesi është gjykuar me procedurën e gjykimit të zakonshëm dhe në të gjitha shkallët e gjykimit, nëpërmjet mbrojtësit të tij, atij i është dhënë mundësia për t`u njohur dhe për të debatuar mbi të gjitha provat e paraqitura nga akuza, si dhe për të paraqitur argumentet dhe provat e tij për çështjen. Po kështu, rezulton se këto pretendime të kërkuesit janë marrë në shqyrtim edhe nga gjykatat e zakonshme. Në lidhje me to, GJKKO-ja e Apelit ka argumentuar se deklarimet e shtetasit N.D. janë marrë dhe vlerësuar në përputhje me ligjin procedural penal dhe janë analizuar në unitet me provat e tjera të çështjes, pa iu dhënë vlerë e paracaktuar dhe duke mos u mbështetur vetëm në to për të provuar fajësinë e të pandehurve, sipas nenit 152, pika 3, të KPP-së. Vendimi i kësaj gjykate është gjetur i drejtë në vijim nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili gjithashtu i ka vlerësuar si të pabazuara këto pretendime të kërkuesit. Sipas Kolegjit Penal, në rastin konkret rezulton se deklarimit e shtetasit N.D. janë marrë dhe vlerësuar në unitet me provat e tjera, duke arsyetuar gjykatat se deklarimet e shtetasit N.D. përputhen me ato të bashkëpunëtorit të drejtësisë E.H., me deklarimet e shtetases A.Sh., si dhe me provat shkresore dhe shkencore të marra në gjykim (*shih paragrafin 29 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

16. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, referuar argumenteve të paraqitura nga kërkuesi në mbështetje të pretendimit të tij për *cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* Kolegji vëren se gjatë gjykimit kërkuesit i janë dhënë mundësi të barabarta për të parashtruar pretendimet e tij për çështje të faktit dhe të ligjit, në kushte të barabarta me organin e ndjekjes penale. Pretendimet e tij për cenimin e këtij parimi kanë të bëjnë, në thelb, me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, çka

nuk i përket juridiksionit kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim.

17. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, me argumentin se deklarimet e bashkëjetueses A.Sh., të dhëna gjatë hetimeve paraprake, nuk duheshin bërë pjesë e dosjes gjyqësore. Sipas kërkuesit, shtetasja A.Sh., bazuar në nenin 158 të KPP-së, gëzonte të drejtën për të mos dëshmuar dhe këto dëshmi nuk mund të përdoreshin si prova për dënimin e tij.

18. Neni 32, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtën për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Në frymën e kësaj dispozite, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ndaj në këtë drejtim detyra e saj (Gjykatës) është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë *(shih vendimet nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 57, datë 21.12.2012; nr. 47, datë 07.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*. Pranimi dhe vlerësimi i provave, si rregull, bëhet nga gjykatat e zakonshme, kurse detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën është marrë prova, ka qenë i rregullt *(shih vendimet nr. 19, datë 02.04.2012; nr. 7, datë 27.04.2005 të Gjykatës Kushtetuese).*

19. Dëshmia si një nga llojet e provave në procesin penal rregullohet nga nenet 153-165/a të KPP-së. Sipas pikës 1, shkronja "ç", të nenit 158 të KPP-së, nuk është i detyruar të dëshmojë ai që edhe pse nuk është bashkëshort i të pandehurit, bashkëjeton ose ka bashkëjetuar me të.

20. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji evidenton se në rastin konkret kërkuesi i ka paraqitur këto pretendime edhe në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Lidhur me to, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se deklarimet e bashkëjetueses së kërkuesit, të dhëna gjatë hetimeve paraprake, janë marrë në përputhje me ligjin procedural penal, pasi asaj i është bërë me dije e drejta për të mos dëshmuar sipas nenit 158 të KPP-së, dhe ka kërkuar të mos përfitojë nga kjo e drejtë duke vijuar me dhënien e dëshmisë. Për këtë arsye, ajo gjykatë ka vlerësuar se këto deklarime janë të vlefshme dhe ka rrëzuar kërkesën për pavlefshmërinë ose për papërdorshmërinë e tyre. Më tej, edhe GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se referuar procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 30.11.2022 dhe atij për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale të datës 13.02.2020, rezulton se janë zbatuar drejt normat procedurale për marrjen e provës nga gjykata e shkallës së parë. Shtetasja A.Sh. është njohur fillimisht me të drejtën për të mos dëshmuar si bashkëjetuese e kërkuesit dhe ka përfituar nga

kjo e drejtë duke u përjashtuar nga detyrimi për të dëshmuar në seancë gjyqësore. Megjithatë, gjatë fazës së hetimeve paraprake kjo shtetase ka hequr dorë nga kjo e drejtë, pasi është njohur nga oficeri i Policisë Gjyqësore me parashikimin ligjor të nenit 158 të KPP-së dhe ka zgjedhur të dëshmojë me vullnet të plotë përpara organit procedues për faktet penale dhe përgjegjësinë e kërkuesit dhe të bashkëpandehurit tjetër E.H. (*shih faqen 29-30 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Vendimmarrjet e gjykatave të faktit janë gjetur të bazuara edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka vlerësuar se deklarimet e dëshmitares A.Sh. janë marrë në përputhje me këtë dispozitë dhe janë verifikuar gjatë procesit gjyqësor, ndaj janë tërësisht të vlefshme dhe të përdorshme për marrjen e vendimit (*shih paragrafin 28 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

21. Për sa më lart, Kolegji çmon se procesi gjyqësor, në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, nuk rezulton të ketë qenë i padrejtë dhe prova në fjalë nuk rezulton e marrë në kundërshtim me parashikimet ligjore. Po kështu, për mënyrën e marrjes së provave dhe vlefshmërinë e akteve procedurale përpara gjykatave të zakonshme, kërkuesit i është dhënë mundësia për të kundërshtuar ligjshmërinë e tyre. Këtyre pretendimeve iu është dhënë përgjigje me vendim të arsyetuar, arsyetim i cili nuk duket të jetë arbitrar në këndvështrimin kushtetues dhe, për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme* është haptazi i pabazuar.

22. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit*, me argumentin se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë analizuar për rolin e tij në vrasje dhe rrethanat personale e familjare, në cenim edhe të *parimit të propocionalitetit*. Po sipas tij, gjykatat nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm për aplikimin e dënimit maksimal me burgim të përjetshëm dhe interesit publik që e justifikon atë, dënim ky që i ka cenuar edhe *lirinë personale*. Në cenim të *parimit të prezumimit të pafajësisë,* ato e kanë deklaruar fajtor në mungesë të provave direkte që provojnë kryerjen prej tij të veprave penale dhe duke vlerësuar si prova dëshmitë e disa shtetasve, pa arsyetuar se çfarë provonin këto dëshmi.

23. Kolegji, nisur nga thelbi i këtyre pretendimeve, çmon që t'i analizojmë ato në drejtim të parimit të *prezumimit të pafajësisë* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit.* Në këtë kuadër, ai do të shqyrtojë edhe pretendimet e tij për *propocionalitetin e dënimit* dhe cenimin e *lirisë personale*.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

24. Kërkuesi ka pretenduar se nuk ekzistojnë prova direkte që provojnë kryerjen e veprave penale për të cilat ai është dënuar. Sipas kërkuesit, gjykatat kanë përmendur si prova dëshmitë e disa shtetasve, por pa arsyetuar se çfarë provojnë këto dëshmi. Ai është dënuar vetëm mbi bazën e një prove të vetme që është dëshmia e bashkëpunëtorit të drejtësisë E.H., i cili në dëshminë e dhënë ka shtrembëruar të vërtetën, i ndihmuar edhe nga të dhënat që i ka mundësuar organi procedues. Po sipas kërkuesit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm se përse kanë aplikuar dënimin maksimal me burgim të përjetshëm. Ato nuk kanë analizuar rrethanat faktike të të dyja vrasjeve për të cilat është akuzuar kërkuesi, për sa i përket rolit të tij në këto vrasje, si dhe rrethanat personale dhe familjare të tij.

25. Parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ky parim kërkon që gjykatat e zakonshme të mos e fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta e të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 12, datë 24.08.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Prezumimi i pafajësisë është përcaktuar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut si një nga elementet e një gjykimi të drejtë, i kërkuar nga neni 6, pika 1, i KEDNJ-së. Ky parim ndalon shprehjen e parakohshme nga vetë gjykata të vlerësimit se personi "i akuzuar për një vepër penale" është fajtor përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin (*shih çështjet Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 12 korrik 2013; Karaman kundër Gjermanisë, datë 27 shkurt 2014*).

26. Gjykata ka theksuar gjithashtu se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar *(shih vendimet nr. 70, datë 15.10.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Po sipas Gjykatës, detyrë e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur

gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese).*

28. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Kolegji do të verifikojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë individualizuar në mënyrë të mjaftueshme faktet penale dhe përgjegjësinë e kërkuesit, kanë identifikuar dhe vlerësuar provat mbi të cilat kanë mbështetur përfundimet e tyre, si dhe nëse arsyetimi i tyre mbështet konkluzionin e fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

29. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprat penale të vrasjes me paramendim për interes në dëm të viktimës E.R., vrasjes me paramendim, për interes, të kryer me egërsi dhe mizori, në dëm të viktimës R.R. dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të kryera në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, si dhe grupi i strukturuar kriminal, duke u bazuar në një sërë aktesh e provash, siç janë procesverbalet e këqyrjes së vendit të ngjarjes, aktet e ekspertimit mjeko-ligjor dhe tekniko-balistik, procesverbalet për këqyrjen e aparatit celular dhe aplikacioneve, provat me dëshmitarë, deklarimet e shtetasve të pyetur me cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale, pyetjen e bashkëpunëtorit të drejtësisë të pandehurit tjetër E.H., si dhe të gjitha provat e tjera të shqyrtuara gjatë gjykimit, të cilat në tërësinë e tyre provojnë, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, kryerjen e këtyre veprave penale nga kërkuesi. Konkretisht, bashkëpunëtori i drejtësisë, i pandehuri tjetër E.H., ka deklaruar se i nxitur nga kërkuesi ka pranuar të bëhet pjesë e grupit të E.A. për t'u bërë vrasës me pagesë. Në mënyrë të detajuar ai ka treguar hapat e ndjekur deri në vrasjen e shtetasve E.R dhe R.R., si dhe për pajisjen me armë zjarri të kërkuesit nga shtetasi E.A. Deklarimet e tij përputhen edhe me dëshminë e shtetasit N.D., deklarimet e shtetases A.Sh., provat e tjera me dëshmitarë, si dhe ato shkresore e shkencore të administruara në gjykim. Po kështu, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, ka rezultuar e provuar se E.A. ka pasur rolin e porositësit dhe organizatorit të vrasjeve të E.R. dhe të R.R., ndërsa kërkuesi dhe E.H. janë përfshirë në realizimin e tyre kundrejt përfitimit pasuror. Në funksion të realizimit të planit kriminal, shtetasi E.A. ka vënë në dispozicion të kërkuesit shuma parash, armë zjarri dhe një telefon të kriptuar, ndërsa mjetet dhe përfitimet për E.H. janë përcjellë nëpërmjet kërkuesit, duke shmangur kontaktet e drejtpërdrejta me të.

30. GJKKO-ja e Apelit e ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë për sa i përket fajësisë së kërkuesit, e cila, sipas saj, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm nga provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe të shqyrtuara sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm

edhe në gjykatën e apelit. Sipas GJKKO-së së Apelit, deklarimet e shtetasit N.D., të lidhura me deklarimet e konfirmuara të shtetasit E.H. në unitet, evidentojnë tre fakte të rëndësishme: i) që grupi kriminal, me qëllim kryerjen e vrasjeve është krijuar përpara anëtarësimit të kërkuesit dhe të pandehurit tjetër E.H.; ii) pjesëmarrjen e kërkuesit dhe të pandehurit tjetër E.H. në këtë grup kriminal; iii) vrasjen e viktimave E.R. dhe R.R. nga grupi i strukturuar kriminal, pjesë e të cilit ishte edhe kërkuesi. Po sipas gjykatës së apelit, vrasjet e shtetasve E.R. dhe R.R., si dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake janë rezultat i një sërë veprimesh të marrëveshjes paraprake dhe të programuara të kryera prej grupit të strukturuar kriminal, pjesëtar i të cilit ishte kërkuesi dhe i pandehuri tjetër E.H.

31. Më tej, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se pretendimet e tij për provueshmërinë e akuzave, fuqinë provuese të provave, ekzistencën e elementeve të veprave penale, si dhe cilësimin juridik të faktit penal, janë shqyrtuar dhe analizuar në mënyrë shteruese dhe të argumentuar nga të dyja gjykatat e faktit, të cilat kanë vepruar në përputhje me ligjin dhe mbi bazën e provave. Sipas Kolegjit Penal, pretendimet që lidhen me vlerësimin e fakteve dhe të provave, janë jashtë juridiksionit ekskluziv ligjor të kësaj gjykate. Po kështu, sipas kolegjit, në kundërshtim nga sa pretendon kërkuesi, dëshmia e bashkëpunëtorit të drejtësisë nuk është konsideruar si provë me vlerë të paracaktuar, por është vlerësuar në lidhje dhe në unitet me provat e tjera deklarative, në përputhje me nenet 36/a dhe 152 të KPP-së. Sipas tij, gjykatat kanë marrë në shqyrtim edhe dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, si dhe deklarimet e lexuara sipas neneve 369 dhe 380 të KPP-së, duke arsyetuar mbi fuqinë e tyre provuese në tërësi. Po sipas Kolegjit, vendimmarrjet e gjykatave të faktit nuk janë mbështetur në një provë të vetme dhe as në një vlerësim të paracaktuar të fajësisë, por në një analizë tërësore dhe të ndërthurur të materialit provues.

32. Në analizë të përmbajtjes së vendimeve të mësipërme, Kolegji çmon se gjykatat e posaçme e kanë deklaruar fajtor kërkuesin, duke shqyrtuar e vlerësuar një tërësi provash, të cilat janë analizuar në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën dhe i kanë bindur ato tej çdo dyshimi të arsyeshëm për kryerjen nga kërkuesi të veprave penale për të cilat është akuzuar. Vendimet e gjykatave janë mbështetur vetëm në faktet e paraqitura gjatë procesit gjyqësor dhe përmbajnë bazën ligjore, analizën e provave, mënyrën e zgjidhjes së çështjes, konkretisht deklarimin e kërkuesit fajtor për veprat penale, për të cilat është akuzuar. Ato kanë dhënë përgjigje të arsyetuara për qëndrimet e mbajtura në deklarimin e fajësisë së kërkuesit, duke shpjeguar lidhjen e provave me njëra-tjetrën, pa i dhënë vlerë të paracaktuar ndonjërës prej tyre. Ato gjykata nuk e kanë nisur procesin gjyqësor me bindjen se kërkuesi ka qenë fajtor dhe as e kanë zhvendosur barrën e provës nga prokurori tek ai.

33. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs nga kërkuesi. Ajo ka marrë në shqyrtim pretendimin në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe në ushtrim të rolit të saj si gjykatë ligji, ajo ka verifikuar këto pretendime, duke arritur në përfundimin se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejt ligjin material dhe procedural. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i plotëson të gjitha elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij. Gjithashtu, nuk konstatohet që interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë të ketë qenë arbitrar në nivelin që të mund të konsiderohet se kërkuesit i janë cenuar të drejtat kushtetuese të pretenduara.

34. Krahas sa më lart, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim dhe analizuar edhe pretendimet e kërkuesit për proporcionalitetin e masës së dënimit në raport me rrethanat rënduese e lehtësuese të parashikuara nga ligjvënësi në këtë drejtim.

35. Paraprakisht, për sa i përket proporcionalitetit të dënimit, Kolegji sjell në vëmendje jurisprudencën kushtetuese, sipas së cilës dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, përcaktimi i veprave penale dhe i llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila, duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Në këtë drejtim, elementet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 47 të KP-së janë përcaktuese në individualizimin e drejtë të dënimeve penale *(shih vendimet nr. 10 datë 28.02.2024; nr. 9, datë 26.02.2016; nr. 47, datë 27.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

36. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Kolegji vëren se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka argumentuar se dënimi që duhej caktuar ndaj tij ishte ai me burgim të përjetshëm, nisur nga rrezikshmëria shoqërore e veprës penale "Vrasja me paramendim", të parashikuar nga neni 78, paragrafi 2, i KP-së, roli organizator i kërkuesit për veprimet e të pandehurit tjetër E.H., fakti se vrasja e të ndjerit R.R. është kryer me egërsi dhe mizori, motivi i kryerjes ka qenë shpërblimi me para, si dhe qëndrimi mohues i kërkuesit. GJKKO-ja e Apelit e ka vlerësuar të drejtë këtë dënim, bazuar në kriteret e nenit 47 të KP-së. Në këtë vlerësim, sipas gjykatës së apelit, nga gjykata e shkallës së parë janë marrë parasysh rrezikshmëria e lartë e veprave penale dhe rëndësia e tyre, rrezikshmëria shoqërore e autorit, mënyra e kryerjes së tyre, dashja direkte, motivi, pjesëmarrja e kërkuesit në grupin e strukturuar kriminal, kontributi i tij në kryerjen e vrasjeve dhe rrethana rënduese, e parashikuar nga neni 50, shkronja "c", i KP-së, e vrasjes me egërsi dhe mizori të viktimës R.R., si dhe dispozitat e nenit 334 të tij, për veprat

e kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Kjo vendimmarrje e gjykatës së apelit është vlerësuar e drejtë në vijim nga Gjykata e Lartë.

37. Për sa më sipër, Kolegji vëren se në përcaktimin e dënimit ndaj kërkuesit gjykatat kanë marrë në analizë edhe rrethanat lehtësuese e rënduese përkundrejt marzheve të dënimit të parashikuara në legjislacionin penal për veprat penale respektive, duke bërë individualizmin e dënimit në përputhje me këto rrethana. Në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, zbatimi i ligjit nga gjykatat, për sa i përket marzhit të dënimit, nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që të bjerë në kundërshtim me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të proporcionalitetit në drejtim të individualizimit të dënimit është haptazi i pabazuar.

38. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *lirisë personale*, me argumentin se është duke vuajtur në mënyrë të padrejtë heqjen e lirisë përmes burgimit të përjetshëm.

39. Kolegji vëren se, sipas nenit 27, pika 2, shkronja "a", të Kushtetutës, liria personale mund të kufizohet në rastet e një dënimi me burgim nga gjykata kompetente. Në rastin konkret, Kolegji evidenton se, në përputhje me parashikimin kushtetues, kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është bazuar në ligj, konkretisht në dispozitat penale përkatëse që përcaktojnë kufizimin e kësaj lirie për veprat penale për të cilat ai është akuzuar, si dhe në vendimet gjyqësore që e kanë deklaruar fajtor për veprat penale të akuzuara, gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar mjaftueshëm për shkaqet mbi të cilat kanë zbatuar dënimin me burgim të përjetshëm. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe pretendimet e kërkuesit për *cenimin e lirisë personale* janë haptazi të pabazuara.

40. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat "d" dhe "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.